


# Indeksi i besimit

*Studimi i gjendjes se marrëdhënieve  
etnike në Kosovë*



# Indeksi i besimit

Studimi i gjendjes se marrëdhënieve  
etnike në Kosovë

**Titulli i hulumtimit:** INDEKSI I BESIMIT - Studimi i gjendjes se marrëdhënieve etnike në Kosovë

**Botuesi:** Qendra Barabar

**Autorët:** Boban Simić, Ognjen Gogić

**Analiza statistikore:** Senka Kostić

**Përkthimi dhe lektorimi:** Srdjan Simonović I.B.

**Dizajni:** Bojan Marinković

**Printimi (tirazhi):** 180

Ky publikim është krijuar me mbështetjen financiare të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë vetëm të autorëve dhe jo domosdoshmërisht përfaqësojnë pikëpamjet zyrtare të UNMIK-ut

**Viti i botimit:** 2024

**Gjetjet kryesore**

## Perceptimet personale

57.6% të të anketuarve nga komuniteti serb dhe 52.6% të të anketuarve nga komuniteti shqiptar konsiderojnë se serbët dhe shqiptarët nga Kosova nuk do të mund t'i besojnë kurrë më njëri-tjetrit

69.2% nga komuniteti serb dhe 64.3% të të anketuarve nga komuniteti shqiptar konsiderojnë se është e rëndësishme të arrihet pajtimi në mënyrë që gjeneratat e ardhshme të jetojnë më mirë në këto zona

## Mediat dhe narrativet publike

72.2% të të anketuarve nga komuniteti serb dhe 63.6% të të anketuarve nga komuniteti shqiptar konsiderojnë se gjuha e urrejtjes në hapësirën mediatike është faktor për thellimin e konfliktit

77.3% të të anketuarve nga komuniteti serb dhe 63.3% të të anketuarve nga komuniteti shqiptar konsiderojnë se propaganda mediatike nga të dy palët është faktor për thellimin e konfliktit

79.3% të të anketuarve nga komuniteti serb dhe 60.9% të të anketuarve nga komuniteti shqiptar konsiderojnë se narrativi i njëanshëm e elitave politike nga të dy palët është faktor për thellimin e konfliktit

## Faktorët që ndikojnë në konflikt

82.9% të të anketuarve nga komuniteti serb dhe 74.5% të të anketuarve nga komuniteti shqiptar konsiderojnë se tensionet politike në lidhje me dialogun ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës është faktor për thellimin e konfliktit

86.9% të të anketuarve nga komuniteti serb dhe 42.8% të të anketuarve nga komuniteti shqiptar konsiderojnë se moskuptimi i pozitës dhe nevojave specifike të komunitetit serb në Kosovë është faktor për thellimin e konfliktit

83.8% të të anketuarve nga komuniteti serb dhe 67.9% të të anketuarve nga komuniteti shqiptar konsiderojnë se një shkallë e lartë e nacionalizmit është faktor për thellimin e konfliktit

65.2% të të anketuarve nga komuniteti serb dhe 59.9% të të anketuarve nga komuniteti shqiptar konsiderojnë se barriera gjuhësore është faktor për thellimin e konfliktit

## Përballja me të kaluarën dhe drejtësia tranzicionale

77.3% të të anketuarve nga komuniteti serb dhe 70.6% të të anketuarve nga komuniteti shqiptar konsiderojnë se historitë e njëanshme për të kaluarën (luftën) janë faktor i thellimit të konfliktit

77.8% të të anketuarve nga komuniteti serb dhe 66.8% të të anketuarve nga komuniteti shqiptar konsiderojnë se mungesa e respektit për viktimat e konfliktit nga të gjitha komunitetet është faktor për thellimin e konfliktit

70.7% e të anketuarve nga komuniteti serb dhe 58.3% nga komuniteti shqiptar nuk besojnë se krimet e luftës të kryera nga pala tjetër mund të falen ndonjëherë

## Si të arrihet zgjidhja

54% të të anketuarve nga komuniteti serb dhe 61.2% të të anketuarve nga komuniteti shqiptar konsiderojnë se promovimi i shkëmbimit kulturor ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve do të ndihmonte në arritjen e paqes dhe të tolerancës ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në territorin e Kosovës

71.7% të të anketuarve nga komuniteti serb dhe 62.6% të të anketuarve nga komuniteti shqiptar konsiderojnë se promovimi i paqes dhe tolerancës nga politikanët e të gjitha komuniteteve do të ndihmonte në arritjen e paqes dhe të tolerancës ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në territorin e Kosovës

69.2% të të anketuarve nga komuniteti serb dhe 59.2% të të anketuarve nga komuniteti shqiptar konsiderojnë se arritja e marrëveshjes përfundimtare ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës do të ndihmonte në arritjen e paqes dhe të tolerancës ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në territorin e Kosovës

## Pozita e komunitetit serb

85.9% të të anketuarve nga komuniteti serb dhe 28.8% të të anketuarve nga komuniteti shqiptar konsiderojnë se autonomia politike për komunitetin serb do të ndihmonte në arritjen e paqes dhe të tolerancës ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në territorin e Kosovës

50% të të anketuarve nga komuniteti serb dhe 55.6% të të anketuarve nga komuniteti shqiptar konsiderojnë se nxitja e integritit të komunitetit serb në shoqërinë kosovare do të ndihmonte në arritjen e paqes dhe të tolerancës ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në territorin e Kosovës

## Akterët e pajtimit

72.2% të të anketuarve nga komuniteti serb dhe 40.4% të të anketuarve nga komuniteti shqiptar konsiderojnë se përfshirja e të rinjve përmes OJQ-ve në procesin e ndërtimit të paqes do të ndihmonte në arritjen e paqes dhe të tolerancës ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në territorin e Kosovës

63.1% të të anketuarve nga komuniteti serb konsideron se BE-ja nuk ndihmon në promovimin e paqes dhe të bashkëpunimit, ndërsa 58.3% të të anketuarve nga komuniteti shqiptar konsiderojnë se BE-ja ndihmon në promovimin e paqes dhe të bashkëpunimit

# 1. Hyrje



Marrëdhëniet ndërmjet komunitetit serb dhe atij shqiptar në Kosovë paraqesin një fenomen i ndërlikuar, të cilin e ngarkojnë sfidat e shumta. Pas konflikteve dhe tensioneve shumëvjeçare, pajtimi midis dy komuniteteve mbetet imperativ për ndërtimin e paqes së qëndrueshme. Gjatë viteve, marrëdhëniet i kanë pasur ulje-ngritjet e tyre, por gjatë viteve të fundit po përjetojnë tensione të reja për shkak të ngecjes së dialogut mes Beogradit dhe Prishtinës në Bruksel, si dhe për shkak të krizës në veri të Kosovës. Edhe pse kanë ekzistuar disa periudha stabiliteti, përçarja aktuale në marrëdhëniet ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës dhe incidentet në terren i komplikojnë më tej marrëdhëniet tashmë komplekse midis dy komuniteteve.

Procesi i pajtimit ndërmjet komunitetit serb dhe atij shqiptar është i rëndësishëm kyçe për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike dhe stabilizimin e gjendjes, jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon më të gjerë. Krijimi i besimit mund të ketë efekte pozitive afatgjata, ndër të cilat është rritja e sigurisë dhe përmirësimi i kushteve socio-ekonomike për të gjitha komunitetet në Kosovë, gjë që do të zvogëlonte shkallën e emigrimit të popullsisë. Përveç kësaj, marrëdhëniet e qëndrueshme në Kosovë do të kontribuonin dukshëm në sigurinë rajonale dhe integrimin e Ballkanit Perëndimor në rrjedhat më të gjera evropiane. Pajtimi gjithashtu luan një rol kyç në parandalimin e konflikteve të ardhshme etnike dhe ndërtimin e paqes së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Në dekadat e fundit, komuniteti ndërkombëtar ka investuar burime të konsiderueshme në procesin e ndërtimit të besimit midis dy komuniteteve. Bashkimi Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe organizatat e ndryshme ndërkombëtare kanë zbatuar programe dhe iniciativa të shumta që e synojnë promovimin e pajtimit dhe të mirëkuptimit të ndërsjellë. Megjithatë, përkundër këtyre përpjekjeve, në terren nuk janë shënuar rezultatet domethënëse, ndërkohë që marrëdhëniet vazhdojnë të përkeqësohen. Shumë nga iniciativat nuk gjetën jehonë adekuate as në mesin e vendimmarrësve brenda komuniteteve dhe as në mesin e popullatës lokale dhe për shkak të kësaj u arrit vetëm një përparim i pjesshëm në uljen e tensioneve. Prandaj, gjatë planifikimit të aktiviteteve të ardhshme që e synojnë pajtimin, është e rëndësishme vendimtare që së pari të hidhet dritë mbi faktorët që kontribuojnë në ndërtimin e besimit, si dhe mbi ata që e pengojnë këtë proces.

Duke e njohur procesin kompleks të pajtimit, ky hulumtim është realizuar me qëllim të arritjes së një kuptimi më të thellë të qëndrimeve dhe perceptimeve të serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë rreth çështjeve kyçe të pajtimit dhe ndërtimit të besimit të ndërsjellë. Qëllimi i hulumtimit ishte identifikimi i qëndrimeve themelore të pjesëtarëve të dy komuniteteve për marrëdhëniet e ndërsjella të tanishme dhe të ardhshme dhe i mundësive të pajtimit, në mënyrë që të përcaktohet niveli i distancës etnike ndërmjet tyre, si dhe të kuptohet ndikimi i faktorëve të ndryshëm në formësimin e këtyre qëndrimeve. Duke i marrë parasysh karakteristikat demografike të të anketuarve, siç janë gjinia, mosha, niveli i arsimit dhe statusi i punësimit, janë analizuar përcaktuesit socio-ekonomikë që ndikojnë në perceptimin e marrëdhënieve të ndërsjella, pajtimit dhe të distancës etnike.

Gjetjet e hulumtimit duhet t'i informojnë krijuesit e politikave dhe të iniciativave të ardhshme të cilat e synojnë pajtimin ndërmjet komunitetit serb dhe shqiptar dhe ndërtimin e paqes së qëndrueshme në Kosovë. Duke i ndërlidhur faktorët demografikë me qëndrimet specifike rreth pajtimit, ky hulumtim ofron informacione përkatëse që mund t'i formojnë strategjitë e ardhshme për avancimin e marrëdhënieve. Kuptimi i perceptimeve dhe qëndrimeve të të anketuarve e mundëson krijimin e programeve që u përshtaten nevojave dhe pritjeve specifike të të dy komuniteteve, duke i rritur kështu perspektivat për arritjen e paqes dhe të stabilitetit të qëndrueshëm.

## **2. Metodologjia dhe dizajni i hulumtimit**

Hulumtimi është zbatuar në terren dhe është kryer në periudhën nga 29 marsi deri më 16 prill të vitit 2024. Metoda e mbledhjes së të dhënave ishte intervistimi ballë për ballë i të anketuarve.

Instrumenti i hulumtimit ka qenë një pyetësor anketues i përbërë nga 11 pyetje të tipit të mbyllur (me përgjigjet e ofruara paraprakisht) të dizajnuara për ta matur perceptimin e ndërsjellë të të anketuarve nga komuniteti serb dhe ai shqiptar, si dhe për ta dhënë vlerësimin e tyre se sa të rëndësishëm janë faktorët e caktuar për perceptimin e ndërsjellë.

Mostra përbëhet nga 500 të anketuar të rritur, nga të cilët 198 të anketuar (39.6%) janë nga komuniteti serb, si dhe 302 të anketuar (60.4%) nga komuniteti shqiptar. Mostra është ndarë në dy nën-mostra sipas përkatësisë etnike të të anketuarve.


Mostra e të anketuarve nga popullata e synuar u përcaktua me metodën e marrjes së mostrave (së rastësishme) me shtresëzim paraprak sipas gjinisë, në mënyrë që të sigurohet përfaqësimi i barabartë i grave dhe burrave në të dy nën-mostrat. Për shkak të mungesës së të dhënave zyrtare statistikore për strukturën demografike të popullsisë serbe në Kosovë, metoda e marrjes së mostrave të shtresëzuara nuk ishte e realizueshme.

# 3. Karakteristikat demografike të mostrës

Përcaktimi i profilit demografik të të anketuarve e mundëson ekzaminimin e përcaktuesve socio-ekonomikë të distancës etnike dhe qëndrimeve ndaj pajtimit. Të anketuarit e moshuar, për shembull, mund të kenë përvoja negative nga e kaluara të cilat ndikojnë në perceptimin e tyre për marrëdhëniet ndërpersonale, ndërsa të anketuarit më të rinj mund të jenë më të hapur për bashkëpunimin ndëretnik. Të anketuarit e papunë mund t'i nënshtrohen qëndrimeve negative për shkak të sfidave socio-ekonomike, derisa të punësuarit mund të shprehin qëndrime më pozitive. Niveli më i lartë i arsimit mund të ndikojë në tejkalimin e paragjyqimeve dhe stereotipave etnikë, duke e ulur kështu distancën etnike. Rolet gjinore mund të formojnë dukshëm qëndrimet ndaj konfliktit dhe pajtimit, prandaj është e rëndësishme të shqyrtohen dallimet e mundshme në qëndrimet midis burrave dhe grave nga të dy komunitetet. Për këto arsye, gjatë analizës së qëndrimeve ndaj pajtimit dhe distancës etnike, është e rëndësishme të merren parasysh gjinia, mosha, niveli i arsimit, statusi i punësimit dhe karakteristikat e tjera demografike të të anketuarve.

Të dhënat demografike për të anketuarit janë paraqitur më poshtë.


*Grafiku 1 Struktura e mostrës sipas gjinisë*



Sipas përkatësisë gjinore, 48.4% të të anketuarve janë femra ndërsa 51.6% të të anketuarve janë meshkuj. Shpërndarja e të anketuarve sipas gjinisë është mjaft e balancuar në të dy komunitetet, gjë e cila lejon një shqyrtim

përfaqësues të të dhënave që i përfshin perspektivat e të dy gjinive. Ky ekuilibër siguron që gjetjet e hulumtimit të mos jenë të njëanshme ndaj asnjërës gjini, gjë që është e rëndësishme për ta kuptuar qëndrimin e përgjithshëm të komuniteteve rreth çështjeve të pajtimit dhe distancës etnike.

*Grafiku 2 Struktura e mostrës sipas moshës*




Sa i përket moshës së të anketuarve, 35% të të anketuarve janë në grupin 18 deri në 29 vjeç, 34% të të anketuarve janë në grupin 30 deri në 45 vjeç, 22.2% janë në grupin 46 deri në 65 vjeç, ndërsa 8.8% të të anketuarve janë 66 vjeç e më lart. Duke e analizuar shpërndarjen e të anketuarve sipas moshës, mund të vërehen dallime të caktuara mes nën-mostrave. Përqindja më e madhe e të anketuarve nga komuniteti serb i përket grupmoshave 30 deri në 45 vjeç (31.3%) dhe 46 deri në 65 vjeç (27.8%). Popullsia e moshuar (66 e më lart) përbën 14.6% të të anketuarve. Grupmoshat më të reja mbizotërojnë te të anketuarit nga komuniteti shqiptar, ku 40.7% të të anketuarve janë nga 18 deri në 29 vjeç dhe 35.8% nga 30 deri në 45 vjeç, ndërsa 5% të të anketuarve janë mbi 66 vjeç.

Dallimet në strukturat e moshës së nën-mostrave mund të pasqyrojnë trende të ndryshme demografike në komunitete, si dhe qëndrime potencialisht të ndryshme ndaj çështjeve të pajtimit. Popullata më e re shqiptare mund të ketë qëndrime të ndryshme për të ardhmen dhe

procesin e pajtimit në krahasim me popullsinë e vjetër serbe, e cila mund të ketë kujtime nga konfliktet.

*Grafiku 3 Struktura e mostrës sipas arsimit*




Sipas strukturës arsimore, 9.6% të të anketuarve e kishin përfunduar shkollën fillore, 45.2% e kishin përfunduar shkollën e mesme, ndërsa 45.2% të të anketuarve e kishin përfunduar fakultetin. Kur bëhet fjalë për arsimin, një nivel relativisht i lartë arsimor mund të vërehet në mesin e të anketuarve nga të dy komunitetet. Në mesin e të anketuarve nga komuniteti serb, 42.4% e kanë përfunduar fakultetin, 52% shkollën e mesme, ndërsa 5.6% e kanë përfunduar vetëm shkollën fillore. Në mesin e të anketuarve nga komuniteti shqiptar, 47% e kanë të përfunduar fakultetin, 40.7% shkollën e mesme, ndërsa 12.3% kanë e përfunduar shkollën fillore.

Niveli i lartë i arsimimit të të anketuarve nga të dy nën-mostrat mund të kontribuojë në qëndrime më të hapura ndaj pajtimit dhe zvogëlimit të distancës etnike, i cili mund të mos pasqyrojë pikëpamjet e komunitetit më të gjerë serb dhe shqiptar në Kosovë. Duhet pasur parasysh se të anketuarit me nivel më të lartë arsimor mund të jenë më të prirë ta pranojnë pjesëmarrjen në hulumtime të këtij lloji.



*Grafiku 4 Struktura e mostrës sipas statusit të punës*



Përqindja e lartë e të anketuarve të papunë (33.3%) nga komuniteti serb mund të tregojë sfidat socio-ekonomike me të cilat përballet, të cilat mund të ndikojnë në qëndrimet ndaj pajtimit dhe distancës etnike. Në të kundërt, përqindja e lartë e të anketuarve të punësuar (70.5%) dhe përqindja më e ulët e të papunësuarve (16.2%) nga komuniteti shqiptar mund ta pasqyrojë situatën e tyre më të qëndrueshme socio-ekonomike, e cila mund të reflektohet edhe në qëndrime më pozitive ndaj së ardhmes.

# 4. Rezultatet e hulumtimit anketues

Pyetjet në kuadër të hulumtimit anketues u grupuan në disa fusha. Bëhet fjalë për fushat e cekura në vijim: perspektivat dhe besimet; akterët e pajtimit; thellimi i konfliktit; arritja e paqes dhe tolerancës; akterët shoqëror; komuniteti ndërkombëtar; distanca etnike.


#### 4.1 Perspektivat dhe besimet

Grupi i parë i pyetjeve përfshinte një sërë pohimesh lidhur me vendosjen e normalizimit të marrëdhënieve dhe arritjen e pajtimit ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve. Të anketuarit u ftuan ta shprehin shkallën e tyre të pajtimit ose të mospajtimit me një pohim të caktuar në një shkallë prej pesë pikësh nga “krejtësisht i/e pasaktë” deri në “krejtësisht i/e saktë”.

Për të shqyrtuar nëse ekziston një ndërlidhje statistikisht domethënëse midis qëndrimeve të të anketuarve dhe disa karakteristikave demografike, siç janë gjinia, mosha dhe arsimi, u përdor testi hi-katror.

Në grafikët në vijim është treguar shpërndarja e përgjigjeve brenda të dy nën-mostrave.

Grafiku 5 Mendoj se marrëdhëniet ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës vetëm mund të përkeqësohen në të ardhmen.




Përgjigjet në pyetjen se sa pajtohen me pohimin se marrëdhëniet ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës vetëm mund të përkeqësohen në të ardhmen tregojnë një qëndrim kryesisht pesimist ndaj të ardhmes së marrëdhënieve. Pothuajse gjysma e të anketuarve nga komuniteti serb (48%) besojnë se marrëdhëniet do të jenë më të këqija, ndërsa te të anketuarit nga komuniteti shqiptar, kjo përqindje është pak më e ulët dhe arrin në 43.3%. Megjithatë, një përqindje e konsiderueshme e të anketuarve nga të dy komunitetet nuk mund të vendosnin (22.2% nga komuniteti serb dhe 33.8% nga komuniteti shqiptar), gjë që tregon pasiguri dhe kujdes.

Duke e aplikuar testin hi-katror në kuadër të nën-mostres nga komuniteti shqiptar, u konstatua se ekziston një ndërlidhje statistikisht domethënëse ndërmjet gjinisë së të anketuarve dhe qëndrimeve për marrëdhëniet e ardhshme mes serbëve dhe shqiptarëve. Ky rezultat sugjeron se shpërndarja e përgjigjeve nuk është e pavarur nga gjinia, pasi burrat dhe gratë nga komuniteti shqiptar iu përgjigjën ndryshe pohimit për marrëdhëniet e ardhshme ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve. Shqyrtimi i shpërndarjeve të përgjigjeve tregon se burrat kanë më shumë gjasa ta konsiderojnë pohimin “krejtësisht të saktë” në krahasim me gratë të cilat ka më shumë gjasa që “nuk mund të vendosin” ose ta konsiderojnë atë si “kryesisht të pasaktë”.

Brenda nën-mostrës nga komuniteti serb, nuk u gjet asnjë ndërlidhje statistikisht domethënëse ndërmjet qëndrimeve dhe karakteristikave demografike të të anketuarve.

*Grafiku 6 Do të nevojitet kohë, por marrëdhëniet mes serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës do të përmirësohen.*



Sa i përket pohimit se marrëdhëniet ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës do të përmirësohen, por se do për një gjë të tillë nevojitet kohë, ka pikëpamje optimiste te të dy komunitetet, edhe pse në shkallë të ndryshme. Më shumë se gjysma e të anketuarve nga komuniteti shqiptar beson në përmirësimin e marrëdhënieve në të ardhmen (56.3%), që është më shumë sesa te të anketuarit nga komuniteti serb (43.9%). Më shumë një e treta e të anketuarve nga komuniteti serb (34.9%) nuk beson në përmirësimin e marrëdhënieve në të ardhmen, që është dukshëm më shumë në krahasim me 14% të të anketuarve nga komuniteti shqiptar.

Rezultatet e testit hi-katror tregojnë se në kuadër të nën-mostrës nga komuniteti shqiptar ka një ndërlidhje statistikisht domethënëse midis gjinisë dhe pajtimit me pohimin se marrëdhëniet do të përmirësohen në të ardhmen. Me fjalë të tjera, burrat dhe gratë nga komuniteti shqiptar kanë perceptime të ndryshme rreth përmirësimit të marrëdhënieve ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në të ardhmen. Për shembull, burrat kanë më shumë gjasa të zgjedhin përgjigjen “krejtësisht i/e saktë” sesa gratë, domethënë ata janë më të prirë të besojnë se marrëdhëniet do të përmirësohen.

Aplikimi i testit hi-katror tregoi se në mesin e të anketuarve nga komuniteti shqiptar, ekziston një ndërlidhje statistikisht e rëndësishme ndërmjet nivelit të arsimit dhe qëndrimeve për përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës. Ekziston dallimi në përgjigjet ndaj pohimit në mesin e të anketuarve me nivele të ndryshme arsimore, ku të anketuarit me arsim të lartë tregojnë optimizëm më të madh. Marrëdhënia midis dy variablave është lineare, gjë që sugjeron një tendencë për rritjen e optimizmit me rritjen e nivelit të arsimit.

Të anketuarit nga komuniteti shqiptar të cilët e kanë përfunduar fakultetin tregojnë optimizëm më të madh sa i përket përmirësimit të marrëdhënieve ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës. Të anketuarit që e kanë përfunduar shkollën fillore e tregojnë nivelin më të ulët të optimizmit sa i përket përmirësimit të marrëdhënieve. Të anketuarit me shkollë të mesme të përfunduar janë mes këtyre dy grupeve, me një nivel të moderuar të optimizmit.

Në kuadër të nën-mostrës nga komuniteti serb, nuk u gjet asnjë ndërlidhje statistikisht domethënëse ndërmjet qëndrimeve dhe karakteristikave demografike të të anketuarve.

*Grafiku 7 Nuk besoj se krimet e luftës të kryera nga pala tjetër mund të falen ndonjëherë.*



Kur bëhet fjalë për krimet e luftës të kryera nga pala tjetër, një përqindje shumë e madhe e të anketuarve nga të dy komunitetet (70.7% nga komuniteti serb dhe 58.1% nga komuniteti shqiptar) nuk beson se ato mund të falen ndonjëherë. Gjetjet e tilla i pasqyrojnë traumat e thella nga lufta që vazhdojnë të rëndojnë marrëdhëniet e ndërsjella. Më shumë se një e katërta e të anketuarve të pavendosur nga komuniteti shqiptar (27.8%) mund të jetë një shenjë se ka potencial për ndryshimin e qëndrimeve.


Testi hi-katror tregon se në kuadër të nën-mostrës nga komuniteti shqiptar ka një ndërlidhje të rëndësishme ndërmjet gjinisë dhe përgjigjes ndaj këtij pohimi. Kjo do të thotë se burrat dhe gratë nga komuniteti shqiptar kanë pikëpamje të ndryshme për mundësinë e faljes së krimeve të luftës. Për shembull, një përqindje më e lartë e meshkujve e zgjedhin përgjigjen “krejtësisht e saktë” në krahasim me gratë. Prandaj, burrat janë më të prirë të besojnë se veprat e këqija nuk mund të falen.

Gjithashtu, testi tregoi se brenda komunitetit shqiptar ekziston një ndërlidhje statistikisht e rëndësishme midis nivelit të arsimimit dhe qëndrimit ndaj pohimit. Gjetjet implikojnë se niveli i arsimimit ndikon dukshëm në mënyrën se si të anketuarit e perceptojnë mundësinë e faljes së krimeve të luftës, në këtë rast ekziston tendenca për ta rritur skepticizmin ndaj faljes me rritjen e nivelit të arsimimit.

Të anketuarit nga komuniteti shqiptar të cilët e kanë përfunduar fakultetin e tregojnë skepticizmin më të lartë në lidhje me mundësinë e faljes së krimeve të luftës të kryera nga pala tjetër, ndërsa të anketuarit që e kanë përfunduar shkollën fillore e tregojnë shkallën më të ulët të skepticizmit. Të anketuarit që e kanë përfunduar shkollën e mesme janë mes këtyre dy grupeve, me një shkallë të moderuar të skepticizmit për mundësinë e faljes.

Në kuadër të nën-mostrës nga komuniteti serb, nuk u gjet asnjë ndërlidhje statistikisht domethënëse ndërmjet qëndrimeve dhe karakteristikave demografike të të anketuarve.

*Grafiku 8 Serbët dhe shqiptarët nga Kosova kurrë më nuk do të mund t'i besojnë njëri-tjetrit.*




Shumica e të anketuarve nga të dy komunitetet pajtohen me pohimin se serbët dhe shqiptarët nga Kosova kurrë më nuk do të mund t'i besojnë njëri-tjetrit. Më shumë se gjysma e të anketuarve nga komuniteti serb (57.6%) beson se besimi nuk do të rikthehet kurrë, ndërsa në mesin e të anketuarve nga komuniteti shqiptar, kjo përqindje e tejkalon gjysmën, por është pak më e ulët (52.6%). Një numër i konsiderueshëm i të anketuarve të pavendosur nga të dy komunitetet (22.7% nga komuniteti serb dhe 28.5% nga komuniteti shqiptar) e tregon ekzistencën e hapësirës për ndërtimin e besimit.

Duke e aplikuar testin hi-katror, u konstatua se në kuadër të dy nën-mostrave ekziston një ndërlidhje statistikisht domethënëse ndërmjet gjinisë dhe qëndrimeve të të anketuarve rreth besimit në të ardhmen ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve. Brenda komunitetit serb, gratë kanë më shumë gjasa ta zgjedhin përgjigjen "kryesisht e saktë" ndërsa burrat kanë më shumë gjasa ta zgjedhin përgjigjen "krejtësisht e saktë". Brenda komunitetit shqiptar, gratë kanë më shumë gjasa se burrat ta zgjedhin përgjigjen "kryesisht e pasaktë", ndërsa burrat kanë më shumë gjasa ta zgjedhin përgjigjen "nuk mund të vendos" ose "krejtësisht e saktë".



*Grafiku 9 Besoj në pajtimin mes serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës.*



Kur bëhet fjalë për besimin në pajtim ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës, ekziston një hendek i konsiderueshëm në qëndrimet e të anketuarve nga komuniteti serb dhe atij shqiptar. Të anketuarit nga komuniteti shqiptar janë dukshëm më optimistë për këtë çështje pasi 58.6% besojnë në pajtim. Kjo është pothuajse dy herë më shumë në krahasim me të anketuarit nga komuniteti serb, ku 30.8% besojnë në pajtim. Në mesin e të anketuarve nga komuniteti serb, pavendosmëria dhe skepticizmi rreth kësaj çështjeje janë të pranishme në një masë më të madhe sesa te të anketuarit nga komuniteti shqiptar. Pothuajse një e treta e të anketuarve nga komuniteti serb (32.8%) është e pavendosur lidhur me këtë çështje, për dallim nga 20.5% të të anketuarve nga komuniteti shqiptar. Mbi një e treta e të anketuarve nga komuniteti serb (36.3%) është skeptike për pajtimin, që është dukshëm më shumë se një e pesta e të anketuarve nga komuniteti shqiptar (20.9%) që mendojnë kështu.

Aplikimi i testit hi-katror tregoi se te të anketuarit nga komuniteti shqiptar ekziston një ndërlidhje statistikisht e rëndësishme midis nivelit të arsimit dhe qëndrimit ndaj pajtimit, dhe se ekziston një ndërlidhje lineare e rëndësishme midis variablave. Rezultatet sugjerojnë se me rritjen e nivelit të arsimit rritet edhe tendenca e bindjes pozitive, gjegjësisht se të anketuarit me arsim më të lartë tregojnë një nivel më të lartë të besimit në pajtim ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve.

Brenda nën-mostrës nga komuniteti serb, nuk u gjet asnjë ndërlidhje statistikisht domethënëse ndërmjet qëndrimeve dhe karakteristikave demografike të të anketuarve.

*Grafiku 10 Është e rëndësishme që të ndodhë pajtimi në mënyrë që brezat e ardhshëm të jetojnë më mirë në këto hapësira.*




Lidhur me rëndësinë e pajtimit për një jetë më të mirë për brezat e ardhshëm, ky pohim ka një nivel të lartë të pajtimit mes të anketuarve nga të dy komunitetet. Rreth dy të tretat e të anketuarve nga komuniteti serb (69.2%) dhe ai shqiptar (64.3%) e njohin rëndësinë e pajtimit për brezat e ardhshëm.

Rezultatet e testit hi-katror tregojnë se në mesin e të anketuarve nga komuniteti shqiptar ekziston një ndërlidhje statistikisht e rëndësishme ndërmjet nivelit të arsimimit dhe qëndrimeve për rëndësinë e pajtimit. Lidhja mes nivelit të arsimimit dhe besimeve është lineare, pasi ekziston një tendencë që mbështetja për pajtimin të rritet me rritjen e nivelit të arsimimit.

Rezultatet tregojnë se të anketuarit nga komuniteti shqiptar me arsim më të lartë kanë një tendencë më të madhe për ta mbështetur këtë ide. Të anketuarit të cilët e kanë përfunduar shkollën fillore kanë prirje ta vlerësojnë më pak rëndësinë e pajtimit në krahasim me të anketuarit të cilët e kanë përfunduar shkollën e mesme ose fakultetin. Të anketuarit që e kanë përfunduar fakultetin e tregojnë mbështetjen më të madhe për pajtimin për një jetë më të mirë për brezat e ardhshëm, ndërsa ata që e kanë përfunduar shkollën e mesme tregojnë një mbështetje mesatare.

Brenda nën-mostrës nga komuniteti serb, nuk u gjet asnjë ndërlidhje statistikisht domethënëse ndërmjet qëndrimeve dhe karakteristikave demografike të të anketuarve.

*Grafiku 11 Kur bisedoj me miqtë e mi, i mbroj qëndrimet pozitive ndaj pajtimit të serbëve dhe shqiptarëve.*



Një numër i konsiderueshëm i të anketuarve nga të dy komunitetet shprehin qëndrime pozitive ndaj pajtimit në bisedat me miqtë. Pothuajse gjysma e të anketuarve nga komuniteti serb (48.4%) dhe më shumë se gjysma e të anketuarve nga komuniteti shqiptar (58.7%) tregojnë gatishmëri për të promovuar qëndrime pozitive. Brenda të dy komuniteteve, ekziston gjithashtu një përqindje e lartë e të anketuarve të pavendosur (27.8% komunitet serb dhe 27.2% nga komuniteti shqiptar), gjë që tregon hapësirë për promovimin e qëndrimeve pozitive.

Rezultatet e testit hi-katror tregojnë se brenda komunitetit shqiptar ekziston një ndërlidhje statistikisht e rëndësishme midis nivelit të arsimimit dhe bindjes rreth kësaj çështjeje. Të anketuarit me arsim më të lartë kanë tendencë më të madhe për ta mbështetur pajtimin ndërmjet dy komuniteteve. Të anketuarit të cilët e kanë përfunduar shkollën fillore kanë prirje t'i mbështesin më pak qëndrimet pozitive për pajtimin në krahasim me të anketuarit të cilët e kanë përfunduar shkollën e mesme apo fakultetin. Të anketuarit të cilët e kanë përfunduar fakultetin e tregojnë prirjen më të madhe për t'i mbështetur qëndrimet pozitive për pajtimin, ndërsa ata të cilët e kanë përfunduar shkollën e mesme tregojnë një nivel mesatar të mbështetjes për pajtimin.

## Diskutimi

Analiza statistikore e rezultateve të mbledhura përmes përgjigjeve ndaj pyetjeve të mëparshme tregon dallime të konsiderueshme në qëndrimet ndaj marrëdhënieve të ardhshme ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës, si dhe ndikimin e karakteristikave demografike në ato qëndrime.

Një përqindje e lartë e qëndrimeve negative në mesin e të anketuarve nga të dy komunitetet në lidhje me të ardhmen e marrëdhënieve dhe mundësinë e faljes së krimeve të luftës tregon mosbesim të rrënjosur thellë. Këto qëndrime paraqesin një pengesë të konsiderueshme për proceset e normalizimit të marrëdhënieve dhe pajtimit. Megjithatë, ka edhe sinjale optimiste të cilat tregojnë se ka potencial për ndërtimin e besimit. Një numër i konsiderueshëm i të anketuarve të pavendosur tregon për ekzistencën e hapësirës për promovimin e qëndrimeve pozitive.

Të anketuarit nga komuniteti shqiptar në përgjithësi kanë një nivel më të lartë të optimizmit lidhur me mundësinë e përmirësimit të marrëdhënieve dhe pajtimit në krahasim me të anketuarit nga komuniteti serb. Një numër i konsiderueshëm i të anketuarve nga komuniteti serb shfaq pavendosmëri, gjë që mund të tregojë pasiguri apo kujdes më të madh ndaj kësaj teme.

Brenda komunitetit shqiptar, gjinia dhe niveli i arsimimit paraqesin përcaktues që luajnë rol të rëndësishëm në formësimin e qëndrimeve ndaj ngjarjeve të së shkuarës dhe marrëdhënieve të ardhshme. Burrat dhe gratë kanë pikëpamje të ndryshme për marrëdhëniet e ardhshme, faljen e krimeve të luftës dhe besimin ndërmjet komuniteteve. Niveli më i lartë arsimor ndërlidhet me optimizëm më të madh për përmirësimin e marrëdhënieve, por edhe me skepticizëm më të madh ndaj mundësisë së faljes së krimeve të luftës. Të anketuarit me nivel më të lartë arsimor kanë prirje më të madhe të besojnë në pajtim ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve. Kjo prirje është lineare, që do të thotë se mbështetja për pajtim rritet me nivelin e arsimimit.

Rreth dy të tretat e të anketuarve nga të dy komunitetet e njohin rëndësinë e pajtimit për jetën e brezave të ardhshëm, ndërkohë që brenda komunitetit shqiptar njihet ndikimi i edukimit në bindjet pozitive. Për më tepër, qëndrimet ndaj promovimit të qëndrimeve pozitive për pajtimin në mesin e miqve tregojnë tendenca pozitive. Shumica e të anketuarve nga komuniteti shqiptar dhe një përqindje e konsiderueshme e të anketuarve nga komuniteti serb tregojnë gatishmëri për të promovuar qëndrime pozitive. Arsimi, edhe këtu, luan një rol të rëndësishëm në komunitetin shqiptar, ku të anketuarit me arsim të lartë më shpesh përfaqësojnë qëndrime pozitive.

Rezultatet tregojnë se arsimi është një faktor i rëndësishëm, veçanërisht në komunitetin shqiptar, në formësimin e qëndrimeve ndaj pajtimit ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës. Të anketuarit nga komuniteti shqiptar me arsim më të lartë tregojnë prirje më të madhe për ta mbështetur pajtimin dhe për ta njohur rëndësinë e tij për brezat e ardhshëm. Përqindja e lartë e të anketuarve të cilët besojnë se krimet e luftës nuk mund të falen pasqyron trauma të thella nga e kaluara. Kjo është një sfidë kyçe që duhet të adresohet në proceset e pajtimit. Dakordimi mbi rëndësinë e pajtimit për brezat e ardhshëm, megjithatë, tregon se pavarësisht nga trashëgimia e së kaluarës, ekziston një kuptim i përbashkët i rëndësisë së ndërtimit të paqes për të ardhmen.

Në shikim të parë, disa përgjigje duken kontradiktore sepse të anketuarit shprehin njëkohësisht pesimizëm dhe optimizëm për të ardhmen e marrëdhënieve. Për shembull, megjithëse shumë të anketuar besojnë se marrëdhëniet do të përkeqësohen, në të njëjtën kohë ekziston një përqindje e konsiderueshme e të anketuarve që beson se marrëdhëniet do të përmirësohen duke pasur kohë të mjaftueshme.


Ky perceptim në dukje kontradiktor dëshmon për kompleksitetin e situatës dhe marrëdhënieve ndërpersonale në gjendje konflikti. Individët në një gjendje konflikti afatgjatë shpesh kanë qëndrime dhe ndjenja komplekse dhe kontradiktore për të njëjtën çështje. Ka mundësi që njëkohësisht ndiejnë pesimizëm për situatën aktuale, por edhe optimizëm për mundësitë afatgjata për përmirësimin e marrëdhënieve. Ky dualizëm mund të jetë reflektim i tensioneve dhe traumave aktuale nga e kaluara, por edhe i dëshirës për një të ardhme më të mirë.

Ngjarjet aktuale, si krizat politike, incidentet në terren dhe ngecjet në dialog, mund ta nxisin pesimizmin dhe ndjenjën se marrëdhëniet do të përkeqësohen më tej. Në të njëjtën kohë, ndërgjegjja për potencialin për përparim në të ardhmen mund ta nxisë besimin se marrëdhëniet në fund do të përmirësohen. Të anketuarit mund të besojnë në të njëjtën kohë se marrëdhëniet në një afat të shkurtër do të jenë më të këqija, për shkak të rrethanave aktuale politike, por se në afat të gjatë, përmes edukimit dhe ndryshimeve të brezave, marrëdhëniet në fund do të përmirësohen. Në këtë mënyrë, përgjigjet kontradiktore pasqyrojnë kompleksitetin e qëndrimeve në kontekstin e një konflikti afatgjatë. Ato pasqyrojnë mosbesim të rrënjësor thellë dhe një përpjekje për ta mbajtur një qëndrim real ndaj sfidave aktuale, por edhe ekzistencën e shpresës për përmirësimin e marrëdhënieve në të ardhmen.

## 4.2 Akterët e pajtimit


Grupi tjetër i pyetjeve kishte të bëjë me akterët nga të cilët varet pajtimi ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve. Të anketuarve iu kërkua të shprehnin shkallën e tyre të pajtimit ose mospajtimit me një pohim të caktuar në një shkallë prej pesë pikësh nga “krejtësisht i pasaktë” deri në “krejtësisht i saktë”.

*Grafiku 12 Pajtimi ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë varet vetëm nga pjesëtarët e këtyre dy popujve dhe nga askush tjetër.*



Më shumë se gjysma e të anketuarve nga të dy komunitetet (54.1% nga komuniteti serb dhe 55% nga komuniteti shqiptar) beson se pajtimi varet kryesisht nga vetë serbët dhe shqiptarët. Të anketuarit nga komuniteti shqiptar janë më të pavendosur (21.90%) rreth kësaj çështjeje në krahasim me të anketuarit nga komuniteti serb (16.7%), ndërsa të anketuarit nga komuniteti serb janë më skeptikë (29.3%) në krahasim me të anketuarit nga komuniteti shqiptar (23.1%).

*Grafiku 13 Pajtimi ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë mund të ndodhë vetëm nën presionin e fuqive në pushtet.*



Pothuajse gjysma e të anketuarve nga komuniteti serb (52.6%) dhe nga komuniteti shqiptar (59.2%) beson se pajtimi mund të ndodhë vetëm nën presionin e fuqive në pushtet. Këto rezultate tregojnë perceptimin se ndikimet e jashtme luajnë një rol kyç në arritjen e pajtimit. Përqindja e të pavendosurve, 19.7% nga komuniteti serb dhe 24.5% nga komuniteti shqiptar, mund të tregojë pasiguri në lidhje me rolin e akterëve të jashtëm. Të anketuarit nga komuniteti serb janë më skeptikë rreth kësaj çështjeje (27.8%) në krahasim me të anketuarit nga komuniteti shqiptar (16.2%).

## Diskutimi

Më shumë se gjysma e të anketuarve nga të dy komunitetet besojnë se pajtimi varet, në radhë të parë, nga vetë serbët dhe shqiptarët. Kjo tregon një ndërgjegje për përgjegjësinë dhe rolin e vet në procesin e pajtimit. Në anën tjetër, më shumë se gjysma e të anketuarve nga komuniteti serb dhe ai shqiptar beson se presioni nga fuqitë në pushtet është i nevojshëm për arritjen e pajtimit. Edhe pse të anketuarit e pranojnë rëndësinë e iniciativave të brendshme për pajtim, të anketuarit në të njëjtën kohë e pranojnë rolin kyç të akterëve të jashtëm në krijimin e presionit.

Këto rezultate tregojnë një tjetër kompleksitet të perceptimit të të anketuarit, i cili mund të duket kontradiktor në shikim të parë. Ata tregojnë se në të dy komunitetet ekziston një perceptim i rëndësishëm së akterëve ndërkombëtarë dhe

vendorë në mbështetjen e procesit të pajtimit. Kjo mund të përfaqësojë pasiguri dhe ambivalencë rreth asaj se kush duhet ta marrë rolin udhëheqës në procesin e pajtimit. Të anketuarit ndoshta besojnë se iniciativat e brendshme kanë potencial për pajtim, por në të njëjtën kohë pranojnë se presioni i jashtëm është i nevojshëm për t'i kapërcyer pengesat.

Këto qëndrime nuk janë domosdoshmërisht kontradiktore, por plotësuese, pasi ato e tregojnë nevojën për një qasje të kombinuar në procesin e pajtimit. Të anketuarit mund të njohin se përpjekjet e brendshme dhe presionet e jashtme duhet të punojnë së bashku për ta arritur paqen e qëndrueshme, sepse njëra pa tjetrën mund të mos jetë e mjaftueshme. Kuptimi dhe adresimi i këtyre qëndrimeve komplekse mund të ndihmojë në krijimin e strategjive efektive për ndërtimin e paqes dhe të besimit të qëndrueshëm ndërmjet komuniteteve.

### 4.3 Thellimi i konfliktit


Pjesa e radhës e anketës përmbante disa pohime rreth çështjes cilat mund të jenë arsyet e thellimit të konfliktit ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në territorin e Kosovës. Përgjigjet u shpërndanë në disa grupe. Të anketuarve iu kërkua të shprehnin shkallën e tyre të pajtimit ose mospajtimit me një pohim të caktuar në një shkallë prej pesë pikësh nga “nuk pajtohem fare” deri në “pajtohem plotësisht”.

Për të shqyrtuar nëse ekziston një ndërlidhje statistikisht domethënëse midis qëndrimeve të të anketuarve dhe moshës, u përdor testi hi-katror. Të anketuarit ishin të ndarë në dy kategori moshe - më të rinj se 30 dhe 30 vjeç e më shumë. Testi u aplikua brenda nën-mostrave individuale si dhe në nivel të të gjithë mostrës. Rezultatet në përgjithësi nuk treguan se kishte dallime në qëndrime në varësi të moshës së të anketuarve.




### 4.3.1 Narrativi publik

*Grafiku 14 Gjuha e urrejtjes në hapësirën mediatike*




Shumica dërmuese e të anketuarve nga të dy komunitetet pajtohet se gjuha e urrejtjes në hapësirën mediatike është një nga arsytet për thellimin e konfliktit. Pothuajse tri të katërtat e të anketuarve nga komuniteti serb (72.2%) pajtohen me këtë pohim, sikurse pak më pak se dy të tretat e të anketuarve nga komuniteti shqiptar (63.6%).

*Grafiku 15 Propaganda mediatike nga të dy palët*



Një shumicë e konsiderueshme e të anketuarve nga të dy komunitetet është e prirë ta shoh propagandën mediatike nga të dy palët si një faktor kyç në thellimin e konfliktit. Më shumë se tri të katërtat e të anketuarve nga komuniteti serb (77.3%) pajtohen me këtë qëndrim, sikurse pothuajse dy të tretat e të anketuarve nga komuniteti shqiptar (63.3%).


*Grafiku 16 Narrativi i njëanshëm i elitave politike nga të dy palët*



Shumica dërrmuese e të anketuarve nga të dy komunitetet i njohin narrativet e njëanshme të elitave politike nga të dy palët si si faktor i cili kontribuon në konflikt. Pothuajse katër të pestat e të anketuarve nga komuniteti serb (79.3%) e pranojnë këtë, sikurse 60.9% të të anketuarve nga komuniteti shqiptar.


Rezultatet e testit hi-katror tregojnë se ekziston një ndërlidhje statistikisht domethënëse midis moshës dhe qëndrimit ndaj pohimit, domethënë ekziston dallimi në qëndrimet midis të anketuarve më të rinj dhe atyre më të moshuar. Të anketuarit më të vjetër kanë prirje të zgjedhin “Nuk pajtohem fare”. Nga ana tjetër, të anketuarit e rinj kanë një tendencë më të madhe për të qenë neutralë, d.m.th. të deklarohen si “as pajtohem as nuk pajtohem”.

*Grafiku 17 Narrativi i njëanshëm i elitave politike nga të dy palët (sipas moshës)*




#### 4.3.2 Tensionet politike

*Grafiku 18 Tensioni politik lidhur me dialogun mes Beogradit dhe Prishtinës*




Tensionet politike në lidhje me dialogun mes Beogradit dhe Prishtinës u njohën si një faktor i rëndësishëm në konflikt nga më shumë se dy të tretat e të anketuarve nga të dy komunitetet. Më shumë se katër të pestat e të anketuarve nga komuniteti serb (82.9%), si dhe tri të katërtat e të anketuarve nga komuniteti shqiptar (74.5%) janë pajtuar me këtë pohim.

*Grafiku 19 Mungesa e mbështetjes institucionale për pajtim nga të dy palët (Beogradi dhe Prishtina)*




Të anketuarit nga të dy komunitetet e njohin mungesën e mbështetjes institucionale për pajtim nga ana e Beogradit dhe Prishtinës si një faktor të rëndësishëm të konfliktit. Më shumë se pesë të katërtat e të anketuarve nga komuniteti serb (81.3%) dhe pothuajse dy të tretat e të anketuarve nga komuniteti shqiptar (65.9%) pajtohen me këtë pohim.

*Grafiku 20 Mungesa e vendosmërisë ndërkombëtare kur bëhet fjalë për negociatat ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës*



Më shumë se katër të pestat e të anketuarve nga komuniteti serb (81.3%) si dhe më shumë se dy të tretat e të anketuarve nga komuniteti shqiptar (68.9%) besojnë se mungesa e vendosmërisë ndërkombëtare në lidhje me negociatat ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës ndikon në konflikt. Ky rezultat e tregon perceptimin e të anketuarve për rëndësinë e një roli aktiv dhe vendimtar ndërkombëtar në zgjidhjen e konflikteve.


*Grafiku 21 Mungesa e të kuptuarit të pozitës dhe nevojave specifike të komunitetit serb në Kosovë*



Një përqindje shumë e lartë e të anketuarve nga komuniteti serb (86.9%) konsideron se keqkuptimi i pozitës dhe nevojave specifike të komunitetit serb në Kosovë është një faktor i rëndësishëm i konfliktit. Kjo e tregon perceptimin e marginalizimit që ekziston te të anketuarit nga ky komunitet. Në mesin e të anketuarve nga komuniteti shqiptar ka një larmi më të madhe mendimesh, kështu që 42.8% të të anketuarve pajtohen me këtë pohim, ndërsa 34.10% janë neutralë. Konstatimi se vetëm një e katërta e të anketuarve nga komuniteti shqiptar (23.2%) nuk pajtohen me këtë pohim tregon se ka hapësirë për promovimin e të kuptuarit të pozitës dhe nevojave të komunitetit serb në mesin e pjesëtarëve të komunitetit shqiptar.


### 4.3.3. Faktoret socio-ekonomik

*Grafiku 22 Shkalla e lartë e nacionalizimit*




Një shkallë e lartë e nacionalizimit u njoh si faktor konflikti nga shumica e të anketuarve nga të dy komunitetet. Më shumë se katër të pestat e të anketuarve nga komuniteti serb (83.8%) dhe më shumë se dy të tretat e të anketuarve nga komuniteti shqiptar (67.9%) pajtohen me këtë pohim.

*Grafiku 23 Barriera gjuhësore*




Shumica e të anketuarve nga të dy komunitetet konsideron se barriera gjuhësore është një faktor i rëndësishëm i konfliktit. Kjo përqindje është më e lartë në mesin e të anketuarve nga komuniteti serb, ku pothuajse dy të tretat pajtohen me këtë pohim (65.2%) në krahasim me të anketuarit nga komuniteti shqiptar, të cilët gjithashtu pajtohen në një përqindje të lartë (59.9%).

*Grafiku 24 Standardi i dobët ekonomik*



Standardi i dobët ekonomik u njoh si një faktor i rëndësishëm i konfliktit në një përqindje të lartë nga të anketuarit nga të dy komunitetet. Pothuajse tri të katërtat e të anketuarve nga komuniteti serb (72.2%) dhe dy të tretat e të anketuarve nga komuniteti shqiptar (66.6%) pajtohen me këtë pohim.

*Grafiku 25 Mungesa e perspektivës për të rinjtë*




Mungesa e perspektivës për të rinjtë u njoh si një faktor konflikti nga shumica dërrmuese e të anketuarve nga të dy komunitetet. Të anketuarit nga komuniteti serb pajtohen me këtë pohim në një përqindje shumë të lartë (86.9%), edhe pse pothuajse dy të tretat e të anketuarve nga komuniteti shqiptar (65.2%) e ndajnë këtë qëndrim.


Rezultatet e testit hi-katror nuk treguan asnjë ndërlidhje statistikisht domethënëse midis moshës së të anketuarve dhe qëndrimit ndaj pohimit. Me fjalë të tjera, mosha nuk është faktori kyç i cili i përcakton qëndrimet e të anketuarve ndaj këtij pohimi. Edhe të anketuarit e rinj, edhe ata të moshuar kanë prirje të pajtohen me pohimin, dhe me këtë rast të anketuarit më në moshë i tregojnë format e ngjashme të pajtimit si ata të rinjtë.



*Grafiku 26 Mungesa e perspektivës për të rinjtë*




*Grafiku 27 Feja*



Feja nuk njihet si faktor konflikti në një përqindje shumë të lartë krahasuar me faktorët e tjerë, ku ekzistojnë qëndrime të ngjashme brenda të dy komuniteteve. Pothuajse gjysma e të anketuarve nga komuniteti serb (49.5%) dhe më shumë se gjysma e të anketuarve nga komuniteti shqiptar (51.3%) konsiderojnë se feja ka ndikim në konflikt. Rreth kësaj çështjeje, 26.20% e të anketuarve nga komuniteti shqiptar dhe 27.80% e të anketuarve nga komuniteti serb janë neutralë.


*Grafiku 28 Mungesa e komunikimit dhe ndërveprimit ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve*



Mungesa e komunikimit dhe ndërveprimit u njoh si një faktor i rëndësishëm i konfliktit nga më shumë se dy të tretat e të anketuarve nga të dy komunitetet. Pothuajse tre të katërtat e të anketuarve nga komuniteti serb (73.3%) si dhe mbi dy të tretat e të anketuarve nga komuniteti shqiptar (69.9%) konsiderojnë se mungesa e komunikimit dhe ndërveprimit ka ndikim në konflikt.


#### 4.3.4 Trashëgimia e luftës

*Grafiku 29 Tregime të njëanshme për të kaluarën (e luftës).*



Tregimet e njëanshme për të kaluarën e luftës njihen si një faktor i rëndësishëm i konfliktit në një përqindje të madhe nga të dy komunitetet. Rreth tri të katërtat e të anketuarve nga komuniteti serb (77.3%) pajtohen me këtë, si dhe një përqindje e lartë e të anketuarve nga komuniteti shqiptar (70.6%).

*Grafiku 30 Mungesa e respektit për viktimat e konfliktit nga të gjitha komunitetet*



Mungesa e respektit për viktimat e konfliktit nga të gjitha komunitetet u njoh si një faktor i rëndësishëm i konfliktit nga një shumicë e konsiderueshme e të anketuarve nga të dy komunitetet. Mbi tri të katërtat e të anketuarve nga komuniteti serb (77.8%) si dhe më shumë se dy të tretat e të anketuarve nga komuniteti shqiptar (66.8%) konsiderojnë se ka mungesë respekti për viktimat e konfliktit nga të gjitha komunitetet.

## Diskutimi

### Narrativi publik

Gjetjet e hulumtimit e tregojnë një nivel të lartë të perceptimit të gjuhës së urrejtjes në hapësirën mediatike si një nga faktorët kyç në thellimin e konfliktit. Ky perceptim është më i theksuar te të anketuarit nga komuniteti serb, gjë që sugjeron shqetësim më të madh në këtë komunitet lidhur me efektet negative të diskursit mediatik. Gjithashtu, të dy komunitetet e njohin propagandën mediatike dhe narrativet e njëanshme politike si faktorë që i kontribuojnë konfliktit.

### Tensionet politike

Një përqindje e lartë e të anketuarve nga të dy komunitetet e njohin nivelin e lartë të tensioneve politike në lidhje me dialogun ndërmjet tyre si faktor të konfliktit. Mungesa e mbështetjes institucionale për pajtim dhe mungesa e vendosmërisë ndërkombëtare u vlerësuan gjithashtu si faktorë të konfliktit nga ana e të anketuarve nga të dy komunitetet.

### Faktorët socio-ekonomikë

Një shkallë e lartë e nacionalizmit dhe një standard i dobët ekonomik u njohën si faktorë të rëndësishëm të konfliktit, me theks më të madh, të cilin e vunë të anketuarit nga komuniteti serb, në mungesën e perspektivës për të rinjtë. Mungesa e komunikimit dhe ndërveprimit ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve njihet gjithashtu si një faktor i rëndësishëm i cili kontribuon në thellimin e konfliktit. Feja nuk u identifikua si faktor kyç në konflikt, gjë që mund të sugjerojë një ndikim më të vogël të dallimeve fetare në krahasim me faktorët e tjerë socio-ekonomikë dhe politikë.

### Trashëgimia e luftës


Tregimet e njëanshme për të kaluarën e luftës u njohën si faktor i rëndësishëm i konfliktit, me një përqindje më të lartë të të anketuarve nga komuniteti serb që e theksojnë këtë. Mungesa e respektit për viktimat e konfliktit nga të gjitha komunitetet u njoh gjerësisht nga të anketuarit nga të dy komunitetet si një faktor i konfliktit.

## 4.4 Arritja e paqes dhe tolerancës

Grupi i radhës i pyetjeve përfshinte disa pohime se çfarë mund të ndihmojë në arritjen e paqes dhe të tolerancës ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në territorin e Kosovës. Pohimet ishin të ndara në disa grupe. Të anketuarve iu kërkua të shprehnin shkallën e tyre të pajtimit ose mospajtimit me një pohim të caktuar në një shkallë prej pesë pikave nga “nuk pajtohem fare” deri në “pajtohem plotësisht”.


### 4.4.1 Pajtimi

*Grafiku 31 Promovimi i shkëmbimit kulturor ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve*




Të anketuarit nga të dy komunitetet kryesisht e mbështesin idenë e promovimit të shkëmbimit kulturor midis komuniteteve të tyre. Një përqindje më e lartë e të anketuarve nga komuniteti shqiptar (61.2%) sesa nga komuniteti serb (54%) e mbështet promovimin e shkëmbimit kulturor. Më shumë të anketuar nga komuniteti serb (27.3%) sesa të anketuar nga komuniteti shqiptar (25.5%) janë neutralë rreth kësaj çështjeje.

*Grafiku 32 Promovimi i paqes dhe tolerancës nga politikanët e të gjitha komuniteteve*




Të anketuarit nga të dy komunitetet e mbështesin në masë të madhe promovimin e paqes dhe të tolerancës nga politikanët e të gjitha komuniteteve. Një përqindje pak më e lartë e të anketuarve nga komuniteti serb (71.7%) sesa nga komuniteti shqiptar (62.6%) e mbështet këtë ide. Më shumë të anketuar nga të dy komunitetet janë neutralë rreth kësaj çështjeje (25.5% nga komuniteti shqiptar dhe 15.7% nga ai serb) sesa skeptikë (11.9% nga komuniteti shqiptar dhe 12.7% nga ai serb).

*Grafiku 33 Kultivimi i narrativit për të kaluarën bazuar në fakte dhe prova*



Shumica e të anketuarve nga të dy komunitetet dhe në një përqindje të ngjashme (54.1% nga komuniteti serb dhe 57% nga ai shqiptar) e mbështet kultivimin e narrativit për të kaluarën bazuar në fakte dhe prova. Një përqindje e konsiderueshme e të anketuarve nga të dy komunitetet (29.1% nga komuniteti shqiptar dhe 26.3% nga komuniteti serb) janë neutralë rreth kësaj çështjeje.


*Grafiku 34 Bashkëpunimi ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në procesin e procedimit të kriminelëve të luftës*



Kur bëhet fjalë për rolin që mund të ketë bashkëpunimi në procedimin të kriminelëve të luftës për pajtim, rezultatet tregojnë se ekzistojnë perceptimet e ndryshme në mesin e të anketuarve nga të dy komunitetet. Rreth kësaj çështjeje, ekziston një nivel më i lartë i pajtimit në mesin e të anketuarve nga komuniteti shqiptar, ku pothuajse dy të tretat pajtohen me atë pohim (63.3%). Në mesin e të anketuarve nga komuniteti serb, më pak se gjysma (47.9%) pajtohet me këtë qëndrim. Përderisa përqindja e të anketuarve neutralë është përafërsisht e njëjtë në të dy komunitetet (23.5% në komunitetin shqiptar dhe 24.2% në komunitetin serb), një përqindje më e lartë e të anketuarve nga komuniteti serb (27.8%) nuk pajtohet me këtë në krahasim me përqindjen e të anketuarve skeptikë nga komuniteti shqiptar (13.2%).

#### 4.4.2 Procesi politik


*Grafiku 35 Vendosja e një sistemi në të cilin të gjitha komunitetet e kanë të drejtën e votës gjatë marrjes së vendimeve të rëndësishme*



Kur bëhet fjalë për vendosjen e një sistemi në të cilin të gjitha komunitetet e kanë të drejtën e votës gjatë marrjes së vendimeve të rëndësishme, ekziston mbështetja e shumicës në mesin e të anketuarve nga të dy komunitetet, por në përqindje të ndryshme. Më shumë se tri të katërtat e të anketuarve nga komuniteti serb (78.3%) pajtohen me këtë, krahasuar me më shumë se gjysmën e të anketuarve nga komuniteti shqiptar (55.6%). Mospajtimi është më i lartë në mesin e të anketuarve nga komuniteti shqiptar (26.8%) krahasuar me të anketuarit nga komuniteti serb (8.5%).




*Grafiku 36 Autonomia politike për komunitetet serbe*




Sa i përket autonomisë politike për komunitetet serbe, ka një hendek të theksuar në qëndrimet ndërmjet dy komuniteteve. Përderisa në mesin e të anketuarve nga komuniteti serb ekziston mbështetja dërrmuese për këtë pohim (85.9%), pajtueshmëria është dukshëm më e ulët në mesin e të anketuarve nga komuniteti shqiptar (28.8%). Nga ana tjetër, të anketuarit nga komuniteti shqiptar tregojnë një shkallë të lartë mospajtimi (42.1%) me këtë qëndrim. Kjo sugjeron një polarizim domethënës të qëndrimeve midis këtyre dy komuniteteve në lidhje me autonominë politike të komuniteteve serbe.

*Grafiku 37 Arritja e marrëveshjes përfundimtare mes Beogradit dhe Prishtinës*



Më shumë dy të tretat e të anketuarve nga komuniteti serb (69.2%) pajtohet me pohimin se arritja e një marrëveshjeje përfundimtare mes Beogradit dhe Prishtinës do të kontribuonte në pajtim. Në mesin e të anketuarve nga komuniteti shqiptar, ekziston një pajtueshmëri e shumicës për rëndësinë e arritjes së marrëveshjes për pajtim, por ajo është më pak e theksuar (59.2%).


*Grafiku 38 Nxitja e integritit të komunitetit serb në shoqërinë kosovare*



Ekziston pajtueshmëria e shumicës brenda të dy komuniteteve në lidhje me nxitjen e integritit të komunitetit serb në shoqërinë kosovare. Niveli i pajtimit është më i lartë në mesin e të anketuarve nga komuniteti shqiptar ku 55.6% pajtohen me këtë pohim në krahasim me 50% të të anketuarve nga komuniteti serb.


#### 4.4.3 Procesi socio-ekonomik

*Grafiku 39 Kthimi i të internuarve në Kosovë dhe kthimi i pronës së sekuestruar pronarëve*




Ekziston një nivel dukshëm i lartë i pajtimit në mesin e të anketuarve nga komuniteti serb (85.4%) në lidhje me kthimin e të internuarve në Kosovë dhe kthimin e pronës së sekuestruar pronarëve të tyre, gjë që tregon mbështetje të fortë për këtë proces brenda komunitetit serb. Në mesin e të anketuarve nga komuniteti shqiptar, po ashtu ekziston pajtueshmëria e shumicës për këtë proces, megjithëse niveli i mbështetjes është më i ulët (53%).

*Grafiku 40 Zhvillimi ekonomik*



Kur bëhet fjalë për rolin e zhvillimit ekonomik në pajtim, ekziston një nivel i lartë i pajtimit në mesin e të anketuarve nga të dy komunitetet. Brenda komunitetit serb, mbi katër të pestat e të anketuarve (83.3%) pajtohen me këtë pohim, ndërsa brenda komunitetit shqiptar, mbi dy të tretat e të anketuarve e mbështesin këtë ide (71.5%).

*Grafiku 41 Përfshirja e të rinjve nëpërmjet OJQ-ve në procesin e ndërtimit të paqes*



Ekziston një dallim domethënës mes qëndrimeve ndërmjet komunitetit serb dhe atij shqiptar në lidhje me përfshirjen e të rinjve përmes organizatave joqeveritare (OJQ) në procesin e ndërtimit të paqes. Pothuajse tri të katërtat e të anketuarve nga komuniteti serb (72,2%) pajtohen me këtë pohim, që është dukshëm më shumë në krahasim me të anketuarit nga komuniteti shqiptar, të cilët kanë një përqindje më të ulët të pajtimit (40,4%), por një nivel të lartë neutraliteti (41,1%) rreth kësaj çështjeje.

## Diskutimi

### Pajtimi

Të anketuarit nga të dy komunitetet me shumicë e mbështesin idenë e promovimit të shkëmbimit kulturor, me një mbështetje disi më të madhe në mesin e të anketuarve nga komuniteti shqiptar. Ekziston një nivel i lartë i mbështetjes për promovimin e paqes dhe të tolerancës nga politikanët e të gjitha komuniteteve, ku të anketuarit nga komuniteti serb kanë treguar

mbështetje disi më të madhe për këtë ide sesa të anketuarit nga komuniteti shqiptar.

Shumica e të anketuarve nga të dy komunitetet e mbështesin kultivimin e narrativeve për të kaluarën bazuar në fakte dhe prova. Ekziston një pajtim më i madh në mesin e të anketuarve nga komuniteti shqiptar sesa në mesin e të anketuarve nga komuniteti serb kur bëhet fjalë për bashkëpunimin gjatë procedimit të kriminelëve të luftës.

### **Procesi politik**

Mbështetja më e madhe ekziston te të anketuarit nga komuniteti serb për vendosjen e një sistemi në të cilin të gjitha komunitetet e kanë të drejtën e votës gjatë marrjes së vendimeve të rëndësishme, ndërsa komuniteti shqiptar tregon një nivel më të ulët të pajtimit me këtë qëndrim. Është i dukshëm polarizimi i qartë i qëndrimeve ndërmjet komunitetit serb dhe atij shqiptar në lidhje me autonominë politike për komunitetin serb, me mbështetje të fortë në mesin e të anketuarve nga komuniteti serb dhe një shkallë të lartë të mospajtimit në mesin e të anketuarve nga komuniteti shqiptar.

Në mesin e të anketuarve nga komuniteti serb ekziston pajtueshmëria e lartë në lidhje me arritjen e marrëveshjes përfundimtare ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës. Me këtë ide pajtohen edhe shumica e të anketuarve nga komuniteti shqiptar, ndonëse është më pak e theksuar. Ekziston niveli i lartë i pajtueshmërisë në mes të dy komuniteteve në drejtim të nxitjes së integritetit të komunitetit serb në shoqërinë kosovare, me një mbështetje disi më të madhe për këtë ide në mesin e të anketuarve nga komuniteti shqiptar. Kur bëhet fjalë për kthimin e të internuarve në Kosovë dhe kthimin e pronave të sekuestruara, ekziston mbështetja e fuqishme për këtë proces në mesin e të anketuarve nga komuniteti serb. Në mesin e të anketuarve nga komuniteti shqiptar, shumica është dakord me këtë proces, por me një nivel më të ulët të mbështetjes.


### **Procesi socio-ekonomik**

Ekziston mbështetja e fortë për zhvillimin ekonomik në të dy komunitetet, me mbështetje më të madhe në mesin e të anketuarve nga komuniteti serb. Ekziston një dallim i rëndësishëm në qëndrimet ndërmjet komunitetit serb dhe atij shqiptar në lidhje me përfshirjen e të rinjve përmes organizatave joqeveritare (OJQ) në procesin e ndërtimit të paqes, me pajtim më të madh në mesin e të anketuarve nga komuniteti serb.

## 4.5 Akterët shoqërorë


Grupi i radhës i pyetjeve përfshinte disa pohime rreth rëndësisë së rolit të disa akterëve shoqërorë në procesin e pajtimit ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve. Të anketuarve iu kërkua ta shprehnin shkallën e tyre të pajtimit ose mospajtimit me një pohim të caktuar në një shkallë prej pesë pikëve nga “nuk ndihmojnë fare” deri në “ndihmojnë plotësisht”.

*Grafiku 42 Mediat*




Gjetjet tregojnë qëndrime të ndryshme të të anketuarve brenda të dy komuniteteve lidhur me rolin e mediave, edhe pse qëndrimet janë të ngjashme kur krahasohen mes komuniteteve. Pothuajse gjysma (46.5%) e të anketuarve nga komuniteti serb konsiderojnë se mediat ndihmojnë në procesin e pajtimit, ndërsa të njëjtin mendim e ndan më shumë se gjysma (51%) e të anketuarve nga komuniteti shqiptar. Megjithatë, 37.8% të të anketuarve nga komuniteti serb dhe 37.1% të të anketuarve nga komuniteti shqiptar konsiderojnë se mediat nuk ndihmojnë në promovimin e paqes dhe të bashkëpunimit.

*Grafiku 43 Akterët politikë lokale*



Kur bëhet fjalë për perceptimin e akterëve politikë lokale, ka mendime të ndara për rolin e tyre, por edhe qëndrime të ngjashme mes të anketuarve nga të dy komunitetet. Pak më pak se gjysma e të anketuarve nga komuniteti serb (45.5%) konsideron se aktorët politikë lokale ndihmojnë në promovimin e paqes dhe të bashkëpunimit, ndërsa një përqindje e përafërt (48%) e të anketuarve nga komuniteti shqiptar e mendojnë të njëjtën gjë. Megjithatë, 40.9% e të anketuarve nga komuniteti serb dhe 38.4% nga komuniteti shqiptar konsiderojnë se akterët politikë vendorë nuk u ndihmojnë fare këtyre proceseve.


*Grafiku 44 Shoqëria civile*



Kur bëhet fjalë për perceptimin e shoqërisë civile, ka ngjashmëri në qëndrimet e të anketuarve nga komuniteti serb dhe ai shqiptar. Shoqëria civile u pa si një faktor i rëndësishëm në promovimin e paqes dhe të bashkëpunimit, ku shumica e të anketuarve nga komuniteti serb (51.5%) dhe afërsisht gjysma e të anketuarve nga komuniteti shqiptar (49.4%) që besojnë se shoqëria civile ndihmon në këtë gjë.




*Grafiku 45 Komuniteti ndërkombëtar*




Kur bëhet fjalë për perceptimin e komunitetit ndërkombëtar, roli i tij vlerësohet më pozitivisht nga të anketuarit nga komuniteti shqiptar. Më shumë se gjysma e të anketuarve nga komuniteti shqiptar (52.3%) konsideron se komuniteti ndërkombëtar ndihmon në promovimin e paqes dhe të bashkëpunimit, ndërsa pak më pak se gjysma e të anketuarve nga komuniteti serb (44.9%) besojnë në këtë. Të anketuarit nga komuniteti serb janë skeptikë në një masë më të madhe për rolin e bashkësisë ndërkombëtare pasi 41% konsiderojnë se nuk ndihmon, krahasuar me 28.2% të të anketuarve nga komuniteti shqiptar që mendojnë kështu.

*Grafiku 46 Punonjësit e arsimit*




Punonjësit e arsimit shihen si akterë të rëndësishëm në promovimin e paqes dhe të bashkëpunimit, megjithëse ekzistojnë mendimet e ndara për kontributin e tyre në këto procese. Një përqindje më e lartë e të anketuarve nga komuniteti serb konsiderojnë se punonjësit e arsimit ndihmojnë në pajtim (42.4%) në krahasim me të anketuarit nga komuniteti shqiptar, prej të cilëve pak më shumë se një e treta e besojnë këtë gjë (37.4%).

### Grafiku 47 Organizatat fetare




Të anketuarit nga komuniteti serb janë më optimistë për kontributin e organizatave fetare në promovimin e paqes dhe të bashkëpunimit pasi që pothuajse gjysma (46.5%) pajtohet me këtë. 29.4% e të anketuarve nga komuniteti shqiptar pajtohen me këtë qëndrim, megjithëse përqindja më e madhe, më shumë se një e treta (37.4%), konsideron se nuk është përgjegjësi apo roli i organizatave fetare ta promovojnë paqen dhe bashkëpunimin.

*Grafiku 48 Intelektualët e pavarur*




Roli i intelektualëve të pavarur u pa me skepticizëm nga të anketuarit nga të dy komunitetet. Një pakicë e të anketuarve nga të dy komunitetet konsideron se intelektualët e pavarur ndihmojnë në promovimin e paqes dhe të bashkëpunimit (41.1% nga komuniteti serb dhe 32.8% nga komuniteti shqiptar). Më shumë se një e katërta e të anketuarve nga komuniteti shqiptar (26.2%) dhe afër një e pesta e të anketuarve nga komuniteti serb (19.7%) konsideron se nuk është as roli dhe as përgjegjësia e intelektualëve të pavarur ta promovojnë paqen dhe bashkëpunimin. Të anketuarit nga të dy komunitetet tregojnë, në përqindje të ngjashme, se janë skeptikë për rolin e intelektualëve në atë proces, pasi 38.9% nga komuniteti serb dhe 41% nga komuniteti shqiptar konsiderojnë se ata nuk ndihmojnë në këtë proces.

Grafiku 49 Shoqatat studentore



Mendimi i të anketuarve nga të dy komunitetet janë mjaft të ndara në lidhje me kontributin e shoqatave studentore në promovimin e paqes dhe të bashkëpunimit. Pakica e të anketuarve nga të dy komunitetet konsideron se ato ndihmojnë në këtë proces, edhe pse kjo përqindje është më e lartë në mesin e të anketuarve nga komuniteti serb (41.4%) krahasuar me të anketuarit nga komuniteti shqiptar (32.8%). Pothuajse një e katërta e të anketuarve nga komuniteti shqiptar (26.2%) konsideron se nuk është përgjegjësi apo roli i shoqatave studentore ta promovojnë paqen dhe bashkëpunimin, me çka pajtohet pothuajse një e pesta e të anketuarve nga komuniteti serb (19.7%).

### Grafiku 50 Organizatat sportive



Sa i përket kontributit të organizatave sportive në promovimin e paqes dhe të bashkëpunimit, mendimet e të anketuarve nga të dy komunitetet janë mjaft të ndara. Përafërsisht e njëjta përqindje e të anketuarve nga komuniteti serb konsideron se e ndihmojnë procesin (40.9%), po edhe se nuk e ndihmojnë (40.4%). Në mesin e të anketuarve nga komuniteti shqiptar, një përqindje pak më e lartë konsideron se nuk e ndihmojnë (42.3%) krahasuar me ata që konsiderojnë se e ndihmojnë (37.7%).

## Diskutimi


Gjetjet tregojnë se ekziston një dallim i rëndësishëm në perceptimet e roleve të akterëve të ndryshëm shoqërorë në promovimin e paqes dhe të bashkëpunimit brenda komunitetit serb dhe atij shqiptar si dhe ndërmjet tyre. Përderisa mediat, shoqëria civile dhe komuniteti ndërkombëtar shihen si akterë pozitivë në procesin e pajtimit, ka mendime të ndara për rolin e punonjësve të arsimit, organizatave fetare, intelektualëve të pavarur, organizatave studentore dhe sportive.

Perceptimet për rolet e akterëve të ndryshëm shoqërorë në procesin e pajtimit ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve tregojnë ngjashmëri, por edhe dallime të caktuara. Të anketuarit nga komuniteti shqiptar kanë qëndrime paksa më pozitive ndaj rolit të bashkësisë ndërkombëtare dhe mediave, ndërsa të anketuarit nga komuniteti serb janë të prirë të kenë vlerësime më pozitive për rolin e shoqërisë civile, punonjësve të arsimit dhe organizatave fetare. Perceptimi për liderët politikë lokalë është i ngjashëm në të dy komunitetet, me një përqindje pak më të lartë të perceptimit pozitiv në komunitetin serb. Skepticizmi ndaj rolit të intelektualëve të pavarur është i pranishëm në të dy komunitetet, ku të anketuarit shqiptarë janë disi më skeptikë. Sa i përket kontributit të organizatave sportive, mendimet e të anketuarve nga të dy komunitetet janë mjaft të ndara. Një përqindje më e lartë e të anketuarve nga komuniteti serb konsideron se shoqatat studentore ndihmojnë, ndërsa një përqindje më e lartë e të anketuarve shqiptarë konsideron se ky nuk është roli i tyre. Në të dy komunitetet, roli i shoqërisë civile u vlerësua më pozitivisht, ndërsa roli i organizatave sportive u vlerësua në mënyrë më modeste brenda të dy komuniteteve.

### 4.6 Komunitetet ndërkombëtare

Grupi i radhës i pyetjeve përfshinte disa pohime rreth rëndësisë së komuniteteve ndërkombëtare në promovimin e paqes dhe të bashkëpunimit ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve. Të anketuarve iu kërkua të shprehnin shkallën e tyre të pajtimit ose mospajtimit me një pohim të caktuar në një shkallë prej pesë pikësh nga “nuk ndihmojnë fare” deri në “ndihmojnë plotësisht”.


Grafiku 51 BE-ja



Të anketuarit nga komuniteti serb kanë qëndrim shumë negativ për rolin e BE-së në promovimin e paqes dhe të bashkëpunimit, ku 43.4% konsiderojnë se BE-ja nuk ndihmon fare, ndërsa 19.7% konsiderojnë se nuk ndihmon pjesërisht. Vërehet një kontrast i theksuar në përgjigjet krahasuar me të anketuarit nga komuniteti shqiptar, shumica e të cilëve (58.3%) konsiderojnë se BE-ja ndihmon në promovimin e paqes dhe të bashkëpunimit.




*Grafiku 52 UNMIK-u*




Të anketuarit nga të dy komunitetet i kanë qëndrimet e ndara mbi kontributin e UNMIK-ut në promovimin e paqes dhe të bashkëpunimit. Shumica e të anketuarve nga komuniteti shqiptar (54.6%) konsideron se UNMIK-u nuk ndihmon në promovimin e paqes dhe të bashkëpunimit, ndërsa më pak se gjysma e të anketuarve nga komuniteti serb (44%) konsideron se UNMIK-u ndihmon në këto procese. Përafërsisht e njëjta përqindje e të anketuarve nga të dy komunitetet (19.2% nga komuniteti shqiptar dhe 19.9% nga komuniteti serb) konsideron se nuk është përgjegjësi dhe as rol i UNMIK-ut ta promovojë paqen dhe bashkëpunimin.

Grafiku 53 KFOR-i




Të anketuarit nga komuniteti serb kanë një qëndrim negativ më të theksuar ndaj rolit të KFOR-it në promovimin e paqes dhe të bashkëpunimit sesa të anketuarit nga komuniteti shqiptar. Pothuajse gjysma e të anketuarve nga komuniteti serb (49.5%) konsiderojnë se KFOR-i nuk i ndihmon këto procese, krahasuar me një të tretën që konsideron se ndihmon (43.4%). Shumica e të anketuarve nga komuniteti shqiptar (55.7%) konsiderojnë se KFOR-i ndihmon në promovimin e paqes dhe të bashkëpunimit.

*Grafiku 54 OSBE-ja*



Shumica e të anketuarve nga komuniteti serb (57.1%) konsiderojnë se OSBE-ja nuk ndihmon në promovimin e paqes dhe të bashkëpunimit, ndërsa një e pesta (20.2%) konsiderojnë se nuk është as përgjegjësi dhe as rol i OSBE-së për ta bërë këtë. Këto përgjigje janë dukshëm të ndryshme nga pikëpamjet e të anketuarve nga komuniteti shqiptar, të cilët kanë një qëndrim më të ekuilibruar ndaj rolit që luan OSBE-ja. Pothuajse gjysma e të anketuarve nga komuniteti shqiptar (49.4%) konsideron se OSBE-ja ndihmon në këtë proces, ndërsa më pak se një e treta (29.8%) konsideron se nuk ndihmon.

Grafiku 55 EULEX-i



Të anketuarit nga komuniteti serb kanë qëndrim të theksuar skeptik ndaj kontributit të EULEX-it në promovimin e paqes dhe të bashkëpunimit, pasi pothuajse dy të tretat (64.6%) konsiderojnë se nuk ndihmon në këtë proces, dhe më pak se një e pesta (19.4%) konsideron se ndihmon. Përkundrazi, pothuajse gjysma e të anketuarve nga komuniteti shqiptar (46.7%) konsideron se EULEX-i ndihmon në promovimin e paqes dhe të bashkëpunimit, ndërsa një e treta (33.8%) konsideron se ai nuk ndihmon në këtë proces.

## Diskutimi

Të dy komunitetet shfaqin qëndrime të ndara ndaj rolit të organizatave ndërkombëtare, por me dallime të konsiderueshme në nivelin e skepticizmit dhe të mbështetjes ndërmjet komuniteteve.

Përgjigjet ndaj pyetjeve tregojnë mendime kontradiktore të të anketuarve nga komuniteti serb dhe shqiptar në lidhje me rolin e organizatave ndërkombëtare në Kosovë dhe kontributin e tyre në promovimin e paqes dhe të bashkëpunimit. Skepticizmi më i madh ndaj organizatave ndërkombëtare është i dukshëm te të anketuarit nga komuniteti serb, ndërsa të anketuarit nga komuniteti shqiptar shpesh kanë një qëndrim më pozitiv ndaj rolit të akterëve ndërkombëtarë.

Ekziston një kontrast i rëndësishëm ndërmjet komuniteteve kur bëhet fjalë për BE-në, ku shumica e të anketuarve nga komuniteti serb ka qëndrim shumë negativ ndaj rolit të BE-së, ndërsa shumica e të anketuarve nga komuniteti shqiptar konsideron se BE-ja ndihmon. Ekziston një perceptim më negativ për UNMIK-un në mesin e të anketuarve shqiptarë në krahasim me të anketuarit serbë. Të anketuarit nga komuniteti serb janë të ndarë rreth KFOR-it, por me tendencë drejt perceptimit negativ, ndërsa shumica e të anketuarve nga komuniteti shqiptar ka perceptim pozitiv. Të anketuarit nga komuniteti serb janë jashtëzakonisht skeptikë ndaj OSBE-së, ndërsa të anketuarit nga komuniteti shqiptar kanë një pikëpamje më të balancuar. Të anketuarit nga komuniteti serb kanë qëndrim shumë negativ ndaj EULEX-it, ndërsa të anketuarit nga komuniteti shqiptar tregojnë një shkallë më të lartë të mbështetjes.

Në kuadër të komunitetit serb, roli i EULEX-it dhe OSBE-së është vlerësuar më negativisht, ndërsa roli i KFOR-it është vlerësuar më së miri. Në mesin e të anketuarve nga komuniteti shqiptar, KFOR-i dhe BE-ja janë vlerësuar më pozitivisht, ndërsa kontributi i EULEX-it shihet si më së paku pozitiv.

# 5. Distanca etnike

Pjesa e fundit e anketave përmbante shkallën e distancës etnike të Bogardusit. Të anketuarit u ftuan ta përjashtojnë vetëm një nga dy mbëdhjetë numrat që e shprehin shkallën e pranimit personal të shqiptarëve/serbëve dhe në këtë mënyrë t'i pranojnë të gjitha ato vlera që janë pas atij numri, domethënë t'i refuzojnë ato që janë para atij numri.


Shkalla e distancës etnike e Bogardusit ofron një pasqyrë se si të anketuarit nga të dy komunitetet e perceptojnë pranimin e personave të kombësisë shqiptare ose serbe në kontekste të ndryshme sociale.

Rezultatet janë paraqitura në tabelën dhe grafikun më poshtë.


*Tabela 1 Distanca etnike*

Do ta pranoja personin me kombësi shqiptare/serbe si:	Popullsia serbe	Popullsia shqiptare
bashkëshort/ bashkëshorte	2.00%	4.60%
të dashur apo partner jashtëmartesor	2.00%	2.30%
Mikun tim personal	22.70%	17.90%
mikun e të gjithë (ose anëtarëve individualë) të familjes sime	7.60%	5.60%
fqinj në ndërtesën time të banimit	4.00%	8.60%
fqinj në rrugën time të banimit	7.60%	9.90%
shëf në vendin e punës	1.50%	4.60%
koleg në profesionin tim	13.10%	10.90%
shtetas të vendit tim	17.20%	10.60%
turist në vendin tim	21.20%	24.80%
nuk është përgjigjur	1.00%	0.00%

*Grafiku 56 Distanca etnike (lineare)*



*Grafiku 57 Distanca etnike (kolona)*





### **Bashkëshorti/ bashkëshortja, i dashuri/ e dashura ose partneri jashtëmartesor / partnerja jashtëmartesore**

Të anketuarit nga të dy komunitetet tregojnë një shkallë më të madhe të distancës sociale ndaj pranimi të partnerëve të një kombësie tjetër në këto marrëdhënie intime. Të anketuarit nga komuniteti serb tregojnë distancë më të madhe sociale ndaj personave me kombësi shqiptare në këtë kategori në krahasim me distancën e treguar nga të anketuarit nga komuniteti shqiptar ndaj personave të kombësisë serbe.

### **Miqte dhe fqinjët**

Të anketuarit nga të dy komunitetet shprehin një shkallë më të lartë të pranimi të miqve sesa fqinjëve të një kombësie të ndryshme. Të anketuarit nga komuniteti serb tregojnë distancë më të vogël sociale ndaj pranimi të miqve të kombësisë shqiptare në krahasim me distancën sociale që kanë të anketuarit nga komuniteti shqiptar ndaj pranimi të miqve të kombësisë serbe. Megjithatë, të anketuarit nga komuniteti serb shprehin një distancë pak më të madhe sociale ndaj fqinjëve të tyre shqiptarë në krahasim me të anketuarit nga komuniteti shqiptar ndaj fqinjëve të tyre serbë.

### **Shefi në vendin e punës, kolegu në profesion**

Të anketuarit nga të dy komunitetet tregojnë distancë më të madhe sociale ndaj pranimi të një personi të një kombësie tjetër si shef në vendin e punës sesa si koleg në profesion. Të anketuarit nga komuniteti serb shprehin më shumë distancë ndaj personave të kombësisë shqiptare në pozitën e shefit, ndërsa të anketuarit nga komuniteti shqiptar tregojnë distancë më të madhe sociale ndaj pranimi të personave të kombësisë serbe për kolegë.

### **Shtetas i vendit, turisti**

Rezultatet për pranimin e turistëve në vend janë pothuajse të barabarta, ndërsa të anketuarit nga të dy komunitetet tregojnë distancë më të madhe sociale ndaj qytetarëve të kombësive të tjera sesa ndaj turistëve. Ky trend është i ngjashëm në të dy grupet, duke sugjeruar se ekziston një kujdes i përgjithshëm ndaj banorëve të përhershëm të kombësisë tjetër. Kjo mund të tregojë se turistët janë të mirëpritur, por se ekziston kujdesi i shtuar apo mosbesimi ndaj banorëve të përhershëm të kombësisë tjetër.

## Diskutimi

Nga këto rezultate, mund të vërehen disa dallime ndërmjet të anketuarve nga komuniteti serb dhe ai shqiptar lidhur me perceptimin dhe qëndrimet e tyre ndaj personave të kombësive të tjera. Për shembull, kur bëhet fjalë për pranimin e bashkëshortit/ bashkëshortes, të dashurit/ dashurës apo partnerit jashtëmartesor/ partneres jashtëmartesore, pastaj pranimin e fqinjëve në një ndërtesë banimi ose në rrugë, si dhe pranimin e shefit në vendin e punës, të anketuarit nga komuniteti serb në përgjithësi tregojnë vlera mesatare më të ulëta, gjë që sugjeron një shkallë më të ulët të pranimin të personave të kombësive të tjera në këto role krahasuar me të anketuarit nga komuniteti shqiptar. Nga ana tjetër, kur bëhet fjalë për pranimin e një miku personal apo familjar, kolegut në profesion, si dhe qytetarëve dhe turistëve në vend, të anketuarit nga komuniteti shqiptar kanë vlera mesatare më të ulëta, gjë që tregon një shkallë më të ulët të pranimin të një personi të kombësisë tjetër në këto kontekste në krahasim me të anketuarit nga komuniteti serb.

### **Përcaktuesit demografikë**

Për të përcaktuar nëse gjinia, moshë, arsimit dhe ndërveprimet e tyre kanë ndikim në perceptimin e distancës etnike, është aplikuar testi ANOVA (analiza e variacioneve).

Në asnjë nga dy nën-mostrat nuk u gjet efekti statistikisht domethënës i gjinisë, moshës dhe arsimit, as në mënyrë të pavarur dhe as në ndërveprim, në distancën etnike. Rezultatet sugjerojnë se gjinia, moshë dhe arsimit, qoftë individualisht apo në kombinim, nuk luajnë rol të rëndësishëm në distancën etnike ndërmjet të anketuarve nga komuniteti serb dhe ai shqiptar.

Këto rezultate tregojnë se qëndrimet ndaj distancës etnike janë relativisht të qëndrueshme në mesin e grupeve të ndryshme demografike brenda të anketuarve nga komuniteti serb dhe ai shqiptar dhe se karakteristikat demografike nuk luajnë një rol kyç në formimin e këtyre qëndrimeve.

# 6. Përfundimi

Rezultatet e hulumtimit hedhin dritë mbi rrjetin kompleks të faktorëve që i formojnë marrëdhëniet ndërmjet komunitetit serb dhe atij shqiptar në Kosovë. Sfidat afatgjata, si trashëgimia e vështirë e së kaluarës së luftës, tensionet politike, narrativet e njëanshme, propaganda mediatike dhe mungesa e mbështetjes institucionale për pajtim, paraqiten si pengesa në rrugën drejt ndërtimit të besimit të ndërsjellë dhe zvogëlimit të distancës etnike. Megjithatë, hulumtimi i tregon edhe faktorët pozitivë që mund të shërbejnë si themel për ndërtimin e marrëdhënieve më të mira ndërmjet komuniteteve në të ardhmen.

Mbështetja e akterëve ndërkombëtarë, angazhimi i shoqërisë civile dhe promovimi i shkëmbimit kulturor dhe tolerancës shquhen si faktorë kryesorë pozitivë që mund të kontribuojnë në ndërtimin e marrëdhënieve pozitive ndërmjet komunitetit serb dhe shqiptar në Kosovë. Megjithatë, këto përpjekje përballen me mosbesim të rrënjosur thellë, sfida ekonomike dhe mungesë perspektive për të rinjtë, të cilët janë faktorë që e vështirësojnë më tej procesin e pajtimit.

Të anketuarit nga të dy komunitetet shprehin skepticizëm ndaj marrëdhënieve të ndërsjella, por në të njëjtën kohë shfaqin edhe njëfarë optimizmi dhe interesimi për përmirësimin e tyre. Një përqindje e lartë e qëndrimeve negative tregon mosbesim të rrënjosur thellë, por një numër i konsiderueshëm i të anketuarve të pavendosur tregon se ka hapësirë për ndryshime të mundshme. Megjithatë, ka edhe dallime të konsiderueshme në qëndrimet e të anketuarve nga të dy komunitetet lidhur me çështje të caktuara, siç është autonomia politike për komunitetin serb, që tregon kompleksitetin e sfidave me të cilat ballafaqohen marrëdhëniet ndëretnike. Përveç kësaj, duhet pasur parasysh faktin se të anketuarit nga të dy komunitetet tregojnë një pikëpamje dukshëm të ndryshme për rolin e palëve të treta, siç janë misionet e shumta ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë me qëllim të dhënies së kontributit në ndërtimin e besimit dhe të pajtimit.

Niveli i arsimimit tregohet të jetë një faktor i rëndësishëm që i formon perceptimet, veçanërisht në komunitetin shqiptar, ku të anketuarit më të arsimuar shprehin optimizëm dhe besim më të madh në pajtim. Dallimet në qëndrimet midis burrave dhe grave, si dhe midis të anketuarve me nivele të ndryshme arsimore, e theksojnë rëndësinë e faktorëve socialë dhe arsimorë në formësimin e perceptimeve. Kjo e tregon nevojën për t'i përshtatur strategjitë e pajtimit me nevojat dhe karakteristikat specifike të grupeve të ndryshme brenda komunitetit në mënyrë që të arrihen efektet më të mira.

Rezultatet e këtij hulumtimi mund të paraqesin një hap të rëndësishëm drejt thellimit të të kuptuarit të dinamikës së marrëdhënieve ndërmjet komunitetit serb dhe shqiptar, si dhe brenda tyre, e po ashtu edhe të faktorëve që

ndikojnë në ato marrëdhënie. Në të njëjtën kohë, ato hedhin dritë edhe mbi qëndrimet dhe perceptimet të cilat i kanë pjesëtarët e dy komuniteteve ndaj rolit të akterëve ndërkombëtarë në proceset e ndërtimit të besimit. Kur merret parasysh e gjithë kjo, rezultatet e këtij hulumtimi mund të ofrojnë udhëzime të vlefshme për veprimin e ardhshëm me qëllim të promovimit të qëndrimeve pozitive dhe pajtimit në mes të komunitetit serb dhe atij shqiptar në Kosovë. Përveç kësaj, ato e tregojnë nevojën për hulumtime të mëtejshme për t'i kuptuar më mirë faktorët që ndikojnë në perceptimin e marrëdhënieve të ndërsjella dhe distancën etnike ndërmjet pjesëtarëve të dy komuniteteve. Roli i hulumtimeve të tilla është të kontribuojnë në krijimin e informuar të politikave dhe programeve të përshtatura që do ta nxisin mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërmjet komuniteteve në Kosovë, duke kontribuar kështu në ndërtimin e besimit dhe të pajtimit si qëllim përfundimtar.